

URDHËR
Nr. 162, datë 10.8.2026

**PËR SHFUQIZIM TË URDHËRIT NR. 42, DATË 15.2.2024, TË MINISTRIT TË
PUNËVE TË BRENDASHME, “PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,

URDHËROJ:

1. Urdhri nr. 42, datë 15.2.2024, i ministrit të Punëve të Brendshme, “Për delegim të kompetencave”, shfuqizohet.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDASHME
Besfort Lamallari